



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 785/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa nr. 275/16, dt. 09.06.2016 e BPrAL Kolegji "Gjilani" për ndryshim të emërimit të institucionit.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Gjilani" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ndryshimin e emërimit të Kolegjit, nga Kolegji "Gjilani" në Kolegji "Nacional i Kosovës". Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 25 gusht 2016 ka vlerësuar kërkesën e BPrAL Kolegji "Gjilani" bazuar në Udhëzimin Administrativ për Emërtimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, nr. 01/2013, datë 16.01.2013, neni 8. KSHC ka konsideruar se emërtimi i propozuar "Kolegji Nacional" është çorientues dhe se krijon keqkuptime në mesin e institucioneve të arsimit të lartë. Rrjedhimisht KSHC ka refuzuar aprovimin e kërkesës të BPrAL Kolegji "Gjilani" për ndryshimin e emërimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Gjilani";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë